



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 188, Datë 21.07.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “C&S CONSTRUCTION ENERGY” SH.P.K. PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË ERE-S NR. 67, DATË 27.10.2011 “PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “DOSKU - ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” DHE HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU ENERGY” SH.P.K. PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; nenit 6 dhe 7 të Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2022; si dhe pikës 2.2 dhe pikës 2.3 të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, Sekretari i Përgjithshëm dhe Këshilltarja e Bordit, me nr. 1144/6 prot., datë 20.07.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011 “Për licensimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike” dhe heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin/revokimin e vendimit të ERE-s nr. 67, datë 27.07.2011 “Për licensimin e shoqërisë “DOSKU - ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike” dhe heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” shpk
- Për të sqaruar rrethanat, faktet dhe pretendimet e shoqërisë dhe po ashtu kompetencën e ERE-s në lidhje me pretendimet e ngritura nga ana e saj, është zhvilluar një korrespondencë e gjatë shkresore me shoqërinë dhe gjithashtu janë zhvilluar dy seanca dëgjimore, përkatësisht në datën 19.04.2022 (me përfaqësues të shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. dhe në datën 06.07.2022 (me përfaqësues të shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY”

sh.p.k., shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

- Referuar sa më sipër, nga ana e shoqërisë është kërkuar shfuqizimi i vendimit të bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.07.2011 “Për liçensimin e shoqërisë “DOSKU - ENERGY” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike” dhe heqja e licencës së kësaj shoqërie, me pretendimin se shoqëria “DOSKU - ENERGY” sh.p.k., nuk ka kontratë koncensionit, nuk ka leje ndërtimi të veprës, nuk ka projekt të miratuar, nuk ka certifikatë përdorimi, nuk ka leje për përdorimin e burimeve ujore dhe në mënyrë të paligjshme ka marrë ujë dhe ka prodhuar energji në dëm të shoqërisë C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k.
- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 67/2011, në ligjin material të sektorit të energjisë elektrike, përkatësisht në nenin 9, pika 4, të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është marrë vendimi nr. 67/2011, që përbën dhe objektin e kërkesës për shfuqizim nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., por edhe ligji aktual në fuqi, nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 16, pika 6 ka parashikuar *se Kundër vendimit të Bordit të ERE-se mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.*
- Sa i përket pretendimit se ky vendim duhet të shfuqizohet sepse është marrë në kundërshtim të hapur me ligjin e kohës nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, tashmë i shfuqizuar, dhe në zbatim të nenit 116 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit nr. 67/2011, përse i përket aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm, si e vetmja pavlefshmëri që mund të kërkohej në çdo kohë, ky akt administrativ është marrë në ushtrim të plotë të kompetencave të ERE-s dhe në të nuk ka element të paligjshëm, nuk plotësohet asnjë nga kushtet sikurse pretenduar nga shoqëria për të kërkuar shfuqizimin e tij, e po ashtu ankimet për një vendim të bordit të ERE-s bëhen pranë organeve gjyqësore, vlerësohet se kjo kërkesë e shoqërisë duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj.
- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., për të hequr licencën e dhënë shoqërisë “DOSKU ENERGY” sh.p.k. në nenin 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në pikën 6.1 të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe në nenin 5 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, është parashikuar si vijon:

ERE heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas ligjit;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike;
- d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- dh) me kërkesë të të licencuarit;
- e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

- Referuar përcaktimeve të gjermës “a” të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të mos përmbushë më kushtet thelbësore të licencës së dhënë.

Për sa i përket kontratës së koncesionit, ERE ka zhvilluar dhe korrespondencë me MIE-n, ku së fundi nëpërmjet shkresës nr. 454 prot., datë 05.04.2022, ka kërkuar informacion sërish në lidhje me subjektin “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. dhe nga ministria, që është organi kompetent në lidhje me përcaktimin e të drejtave koncesionare, nuk ka ende një vendim përfundimtar. Ndërsa në lidhje me marrjen e masave përkatëse për sa referuar dhe në shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr. 1167/4 prot., datë 24.09.2020 drejtuar MIE-s, për dijeni shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. nga MIE në seancën dëgjimore të datës 06.07.2022 u deklarua se Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka bërë verifikimet përkatëse në terren dhe në vijim do të njoftonte ERE-n dhe mbi masat e marra pas këtyre verifikimeve. Në çdo rrethanë vlen të evidentohet se mbikëqyrja e kontratës së koncesionit apo e respektimit të kuotave sipas përcaktimeve në këtë kontratë nuk është kompetencë e ERE-s, ndaj dhe vetë AKBN e ka orientuar çështjen për ndjekje në MIE.

Rezulton se nuk ka një akt apo vendim nga ana e organit kompetent, që është MIE për çështjen e shoqërisë koncesionare “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., që të përbëjë shkak për fillimin e një procedure për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k.

- Përsa i përket lejes së ndërtimit, ERE nuk është organi kompetent për dhënien apo revokimin e këtyre lejeve. Në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, organi përgjegjës është IKMT, i cili në zbatim të përcaktimeve të këtij ligji ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor, që kanë të bëjnë, ndër të tjera dhe me sektorin e energjisë elektrike. Subjekti “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. depozitoi në ERE një kopje të vendimit të IKMT për pezullimin e punës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k.
- Për sa i përket certifikatës së përdorimit dhe dokumentacionit pronësor, , pas korrespondencës përkatëse dhe pas depozitimit nga ana e shoqërisë të Çertifikatës përkatëse të regjistrimit të

pronësisë bordi i ERE-s me vendimin e ERE-s nr. 79, datë 31.05.2019 ka vendosur shfuqizimin e kushtit.

Për sa i përket lejes së përdorimit të burimeve ujore, ERE ka zhvilluar korrespondencë të gjatë dhe gjithashtu një takim me drejtues të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), në datën 02.06.2022. Në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, dhe për sa përcaktuar në vetë shkresat e AMBU-së, e cila bën me dije se ka njoftuar institucionet përkatëse për marrjen e masave, nuk është kompetencë e ERE-s konstatimi i vlefshmërisë së lejeve për përdorimin e burimit ujor përkatës dhe ERE nuk mund të ndër marrë asnjë veprim pa rakorduar më parë modalitetet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, për sa kohë kjo është një praktikë që po ndiqet në vijim në lidhje me marrjen e masave përkatëse nga institucionet sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë së tyre. Gjithashtu gjatë mbledhjes së bordit për këtë vendimmarrje, kërkuesi ka bërë me dije dhe ka depozituar në ERE kopje të Vendimit përfundimtar me reference Nr. IKMT-DQ-2022-000112 – 5, datë 14.07.2022 të IKMT për marrjen e masës administrative pezullim i aktiviteti kundër shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k.

Sa i përket ndërtimeve të paligjshme, vetë neni 96 i ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, përcakton se inspektoriatet përkatëse, në bazë të shkeljes, vendosin detyrimin për rregullimin e pasojave dhe të dëmit përkatës. Në këto rrethana ligji përkatës ka orientuar e përcaktuar organin kompetent për shpërblimin e dëmit që vërtetohet se vjen si pasojë e shkeljeve që shoqëria “C&S CONSTRUCTION” sh.p.k. pretendon se duhet t’i rregulloj ERE, e cila në asnjë nen të këtij ligji nuk është organ zbatues apo i ngarkuar me këtë detyrim.

- Për sa i përket kapacitetit të instaluar, në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, përcaktohet se: *I Liçensuari do të njoftojë menjëherë ERE-n për çdo ndryshim në fuqinë e instaluar të secilit prej Njësive Prodhuese ose centraleve elektrike të identifikuara ne Aneksin A që rrisin ose ulin kapacitetin prodhues të disponueshem nga i Liçensuari.*
- Në seancën dëgjimore të datës 19.04.2022, të zhvilluar me qëllim saktësimin e objektit të kërkesës së shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” shpk, nga ana e kësaj të fundit u pretendua, ndër të tjera, se shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k, ka vendosur një turbinë shtesë, prej 1.4 MW. Nga ana e ERE-s është kërkuar që shoqëria të dokumentojë çdo pretendim të saj. Nga ana tjetër, u vlerësua dhe mbajtja e një seancë të dytë dëgjimore, ku të ishin të pranishme të gjitha palët e interesit, seancë e cila u zhvillua në datën 06.07.2022. Në këtë seancë, shoqëria “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., ngriti sërish pretendimin për rritjen e fuqisë së instaluar të këtij subjekti, përtej kufijve të lejuar nga licenca. Në të njëjtën seancë, nga ana e personave që përfaqësonin shoqërinë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., u deklarua se kapaciteti i instaluar është 600 kW. Licenca e shoqërisë “DOSKU-ENERGY” shpk, është dhënë me vendimin e Bordit nr. 67/2011, për kapacitetin 500 kW.

Po ashtu edhe në mbledhjen e Bordit datë 21.7.2022 u deklarua nga shoqëria C&S COONSTRUCTION sh.p.k., se pretendimin për rritjen e kapacitetit e referojnë në shkresën e AKBN-së nr. 1167/4 prot., datë 24.09.2020. Në këtë shkresë AKBN ka informuar MIE-n më se punimet e HEC Gizavesh po devijojnë rrjedhën e ujit që furnizon veprën e marrjes të HEC Rapun 1 dhe në mënyrë të jashtëligjshme kanë rritur kapacitetin e turbinës dhe gjeneratorit. Në këto rrethana, duke qenë se i licencuari nuk ka njoftuar ERE-n dhe po ashtu nuk ka kërkuar amendim të licencës për rritjen e kapacitetit të instaluar mbi 10%, rezulton se ai ka shkelur një nga kushtet e kësaj licence.

- Referuar përcaktimeve të gërmës b), të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të ketë shkelur dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij.

Në zbatim të nenit 66 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ERE nuk mund të shprehet në lidhje me ndërtimet e paligjshme, e po ashtu të përcaktojë nëse këto ndërtime dëmtojnë mjedisin, sa kohë kjo çështje është në shqyrtim nga një organ tjetër administrativ, hetimor apo gjyqësor. Në çdo rrethanë, duhet theksuar se edhe pasi organet përkatëse të shprehen, vendimmarrja e tyre duhet të afektojë vendimmarrjen e ERE-s në funksion të ushtrimeve të kompetencave të saj dhe vetëm brenda këtyre kompetencave që i njeh ligji material dhe aktet nënligjore në fuqi.

Për sa më sipër, nuk rezulton që të jetë dokumentuar se shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të ketë shkelur dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, të tilla që të fillojnë një procedure për heqjen e licencës së kësaj shoqërie për këtë kusht.

- Referuar përcaktimeve të gërmës c) të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. të ketë rrezikuar jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve.

Sqarojmë se procedura administrative në këtë rast ndërthuret me atë civile apo penale, pasi që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, për shkak të shkeljes së këtij kushti, duhet që të përmbushen dy parakushte dhe të vërtetohet lidhja shkak-pasojë: të jetë vërtetuar që i licencuari të ketë rrezikuar jetën apo pasurinë e qytetarëve dhe që kjo të ketë ardhur pikërisht gjatë ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike. Nga ana e shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. nuk rezulton që të jetë provuar e dokumentuar një pretendim i tillë, ku të jetë vërtetuar se si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “DOSKU ENERGY” sh.p.k. të jetë rrezikuar jeta apo pasuria e personave të kësaj shoqërie, dokumenti i cili duhet të mbajë vulën e organeve përkatëse që kanë dhe kompetencën për të përcaktuar ardhjen e një pasoje të tillë.

Rezultojnë të padukementuara kushtet e sipërcituar që mund të përbënin shkak për nisjen e procedurës për heqjen e licencës së tij për këtë kusht.

- Referuar përcaktimeve të gjurmës ç), të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të mos ketë kryer pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i ligjit për sektorin e energjisë elektrike. Rezulton se shoqëria nuk është debitore sipas përcaktimeve të sipërcituara.
- Referuar përcaktimeve të gjurmës d), të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të bëhet financiarisht i paafhtë ose të kërkojë shpalljen e falimentimit.
Rezulton se nuk jemi në kushtet e paafhtësisë financiare, e po ashtu nuk është depozituar asnjë dokument ku të jetë kërkuar shpallja e falimentit sipas këtij kushti.
- Referuar përcaktimeve të gjurmës dh), të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të ketë depozituar vetë një kërkesë të tillë. Rezulton se nuk jemi në kushtet e një kërkesë të tillë.
- Referuar përcaktimeve të gjurmës e), të nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe pikës 6.1 të kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, që ERE të nisë një procedurë për heqje licence, duhet që i licencuari, e në këtë rast shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. të ketë pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës. Rezulton e pa dokumentuar, kushtet e sipërcituara që mund të përbënin shkak për nisjen e një procedurë për heqje licence. Gjithashtu gjatë mbledhjes së bordit për këtë vendimmarrje, kërkuesi ka bërë me dije dhe ka depozituar në ERE kopje të urdhërit të nxjerrë nga IKMT për marrjen e masës administrative pezullim i aktiviteti kundër shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.10.2011, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. për shkelje të kushtit të vendosur në pikën 2.2 të kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
3. Shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “C & S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., shoqërinë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI